REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.	_____, më __. __.2026
Vendim nr. _____	Datë __. __.2026

PROJEKT-VENDIM

"PËR SHPREHJEN E DAKORDËSISË/MOSDAKORDËSISË SË KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET MBI PROJEKTLIGJIN "PËR NDARJEN ADMINISTRATIVE-TERRITORIALETË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

Këshilli Bashkiak Përmet, i mbledhur në mbledhjen e datës 23.09.2026, pasi shqyrtoi projektligjin"Për ndarjen administrative-territorialetë të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, dokumentacionin e vënë në dispozicion, mendimet e paraqitura gjatë procesit të konsultimit dhe interesat e komunitetit vendor,

Mbështetur në:

- nenin 108, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit kufijtë e njësive të vetëqeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to;
- nenet 86–90 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", veçanërisht kërkesat për argumentimin e riorganizimit, paraqitjen e mendimit të popullsisë së njësive që riorganizohen dhe marrjen e mendimit zyrtar të këshillave bashkiakë të përfshirë drejtpërdrejt;
- të drejtën dhe përgjegjësinë e Këshillit Bashkiak Përmet për të përfaqësuar interesat e komunitetit vendor dhe për t'u shprehur institucionalisht mbi çdo ndryshim që prek statusin, territorin, përfaqësimin, financat, pasuritë dhe vazhdimësinë e shërbimeve vendore;

V E N D O S I:

1. Të shprehë dakortësinë/mosdakordësinë e Këshillit Bashkiak Përmet me propozimin e paraqitur nëpërmjet projektligjit për bashkimin e Bashkisë Përmet me Bashkinë Këlcyrë dhe me humbjen e statusit të Bashkisë Përmet si njësi më vete e vetëqeverisjes vendore.

Scanned with CamScanner

2. Të kërkojë që Bashkia Përmet të ruhet si njësi e mëvetësishme e vetëqeverisjes vendore, me territorin, organet përfaqësuese, administratën, buxhetin dhe përgjegjësitë e saj ligjore.

3. Ky qëndrim mbështetet në nevojën për ruajtjen e përfaqësimit të drejtpërdrejtë vendor, afërsisë së vendimmarrjes me qytetarët, aksesit në shërbime, identitetit territorial e komunitar, si dhe administrimit të qëndrueshëm të financave, pasurive, detyrimeve dhe investimeve vendore.

4. Të konstatojë se çdo riorganizim duhet të paraprihet nga marrja reale, e dokumentuar dhe e verifikueshme e mendimit të popullsisë së Bashkisë Përmet dhe nga paraqitja e plotë e argumenteve ekonomike, sociale, kulturore, demografike, administrative, financiare dhe pasurore për rastin konkret.

5. Të kërkojë që në dosjen parlamentare dhe në raportin përfundimtar të procesit të pasqyrohet i plotë ky vendim, së bashku me çdo mendim kundër të anëtarëve të këshillit dhe me dokumentacionin e konsultimit të komunitetit vendor.

6. Kryetari i Këshillit Bashkiak autorizohet t'ia përcjellë këtë vendim Kuvendit të Shqipërisë, komisionit parlamentar përgjegjës, propozuesve të projektligjit, Këshillit të Ministrave, Prefektit të Qarkut Gjirokastër dhe institucioneve të tjera të interesuara.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

ARSYETIM I SHKURTËR

- Bashkimi i propozuar përbën riorganizim me ndryshim kufijsh dhe prek drejtpërdrejt statusin juridik e institucional të Bashkisë Përmet.
- Mendimi institucional i Këshillit Bashkiak Përmet duhet t'i bashkëlidhet propozimit dhe të merret brenda afatit ligjor nga data e marrjes së kërkesës për shprehje mendimi.
- Mendimi i popullsisë së territorit të prekur duhet të jetë paraprak, real, territorial, i dokumentuar dhe i verifikueshëm; një konsultim i përgjithshëm nuk e zëvendëson këtë kërkesë.
- Përpara vendimmarrjes përfundimtare duhet të qartësohen pasojat mbi financat, pasuritë, detyrimet, kontratat, personelin, investimet në vazhdim dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike për komunitetin e Përmetit.

Anëtarë gjithsej	Të pranishëm	Pro	Kundër / Abstenim
15			

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ANILA DHIMITRI

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

RELACION

"PËR SHPREHJEN E DAKORDËSISË/MOSDAKORDËSISË SË KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET MBI PROJEKTLIGJIN "PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

I. QËLLIMI I RELACIONIT

Ky relacion hartohet me qëllim paraqitjen e fakteve, të dhënave dhe argumenteve që lidhen me propozimin për ndryshimin e ndarjes administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, konkretisht me propozimin për bashkimin e **Bashkisë Përmet** me **Bashkinë Këlcyrë**, si dhe për t'i krijuar Këshillit Bashkiak Përmet bazën e nevojshme për shprehjen e qëndrimit të tij institucional.

Relacioni mbështetet në projektligjin dhe dokumentacionin shoqërues të paraqitur pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në projektvendimin e propozuar për shqyrtim nga Këshilli Bashkiak Përmet.

II. KUADRI I PROPOZUAR NGA PROJEKTLIGJI

Sipas dokumentacionit të paraqitur, projektligji parashikon riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale, duke propozuar konsolidimin e disa bashkive ekzistuese. Në kuadër të Qarkut Gjirokastër, propozimi përfshin edhe **Bashkinë Përmet dhe Bashkinë Këlcyrë**, të cilat parashikohet të përbëjnë një njësi të konsoliduar të qeverisjes vendore, me **qendër qytetin e Përmetit.**

Sipas strukturës së propozuar, njësia e re do të përfshinte territorin e dy bashkive ekzistuese, ndërsa në organizimin e brendshëm do të parashikoheshin dy qytete përbërëse:

- **Qyteti Përmet**, me njësitë administrative Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë;
- **Qyteti Këlcyrë**, me njësitë administrative Këlcyrë, Ballaban, Sukë dhe Dëshnicë.

Dokumenti shoqërues e paraqet njësinë e re me një territor të konsoliduar prej dy bashkive ekzistuese dhe me gjithsej 9 njësi administrative.

Projektligji parashikon gjithashtu një strukturë të re të organizimit të brendshëm të bashkive, ku bashkia përbëhet nga qytete dhe qytetet nga njësitë administrative dhe/ose fshatrat. Përfaqësimi i bashkisë parashikohet të mbështetet në parimin e përfaqësimit proporcional të qyteteve përbërëse, në raport me popullsinë e tyre.

Scanned with CamScanner

III. NDRYSHIMI I PROPOZUAR PËR BASHKINË PËRMET

Ky dokumentacioni rezulton se Bashkia Përmet, në strukturën aktuale, përfshin qytetin e Përmetit dhe njësitë administrative Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë.

Propozimi i ri parashikon që territori aktual i Bashkisë Përmet të integrohet me territorin e Bashkisë Këlcyrë në një njësi të vetme të qeverisjes vendore. Në dokumentin argumentues, qyteti i Përmetit përcaktohet si qendra e bashkisë së konsoliduar.

Ky ndryshim nuk lidhet vetëm me kufijtë territorialë të njësisë së qeverisjes vendore, por prek edhe organizimin institucional, përfaqësimin vendor, administrimin e pasurive, detyrimeve, marrëdhënieve juridike, burimeve financiare, administratës dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike.

IV. NEVOJA PËR VLERËSIMIN E INTERESAVE LOKALE

Dokumentacioni shoqërues i projektligjit paraqet si argument për konsolidimin e Përmetit dhe Këlcyrës ekzistencën e lidhjeve historike, ekonomike, sociale dhe funksionale ndërmjet dy territoreve, si dhe lidhjen e tyre përmes luginës së Vjosës.

Në të njëjtën kohë, përpara marrjes së një qëndrimi përfundimtar institucional, është e nevojshme që këto argumente të vlerësohen edhe nga këndvështrimi i komunitetit të Bashkisë Përmet, duke marrë në konsideratë karakteristikat e territorit, distancat nga qendra administrative, nevojat e njësive administrative, aksesin në shërbime dhe interesat e banorëve.

V. PËRFAQËSIMI DHE AFËRSIA E QEVERISJES VENDORE

Një nga çështjet kryesore që kërkon vlerësim është ndikimi i riorganizimit në marrëdhënien ndërmjet institucioneve vendore dhe komunitetit.

Bashkia Përmet ushtron aktualisht funksionet e saj në territorin e përcaktuar nga ndarja administrativo-territoriale në fuqi, përmes organeve të zgjedhura dhe administratës vendore.

Projektligji parashikon që qytetet përbërëse të kenë një status të veçantë ligjor dhe që përfaqësimi i bashkisë të mbështetet në përfaqësimin proporcional të qyteteve përbërëse.

VI. VIJIMËSIA E SHËRBIMEVE DHE E INVESTIMEVE PUBLIKE

Një tjetër element që kërkon vlerësim të posaçëm është garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve publike dhe i investimeve të planifikuara apo në proces zbatimi.

Dokumentacioni i projektligjit parashikon parimin e vazhdimësisë funksionale, sipas të cilit pasuritë dhe burimet duhet t'i kalojnë institucionit që merr përgjegjësinë përkatëse, pa ndërprerje të shërbimeve publike dhe pa pasiguri në marrëdhëniet juridike ekzistuese. Gjithashtu, parashikohet vijimi i investimeve sipas kontratave të lidhura.

VII. MENDIMI I POPULLSISË DHE KONSULTIMI PUBLIK

Marrja në konsideratë e mendimit të popullsisë përbën një element themelor të procesit të ndryshimit të ndarjes administrativo-territoriale.

Scanned with CamScanner

Vetë dokumentacioni i projektligjit e trajton mendimin e popullatës si një nga kriteret e posaçme të vlerësimit të riorganizimit territorial dhe e lidh atë me kërkesat e nenit 108, pika 2, të Kushtetutës.

Në kuadër të këtij procesi, Bashkia Përmet dhe Këshilli Bashkiak kanë zhvilluar veprimtari të informimit dhe konsultimit publik me komunitetet dhe grupet e interesit, përfshirë:

- dëgjesën dhe konsultimin publik në Njësinë Administrative Çarshovë, më datë 08.09.2026;
- dëgjesën dhe konsultimin publik në Njësinë Administrative Petran, më datë 09.09.2026;
- dëgjesën dhe konsultimin publik në Njësinë Administrative Piskovë–Frashër, më datë 10.09.2026;
- dëgjesën dhe konsultimin publik me gratë dhe të rinjtë, më datë 10.09.2026.

Procesverbalet, listat e pjesëmarrësve, mendimet e shprehura dhe dokumentacioni tjetër përkatës përfshihen si pjesë e dokumentacionit shoqërues të qëndrimit të Këshillit Bashkiak, bashkëlidhur relacionit.

VIII. PËRFUNDIME DHE PROPOZIM

Në përfundim, duke marrë në konsideratë përmbajtjen e projektligjit, dokumentacionin shoqërues, strukturën e propozuar për Bashkinë Përmet dhe Bashkinë Këlcyrë, si dhe procesin e informimit dhe konsultimit publik të zhvilluar me komunitetin, propozohet që Këshilli Bashkiak Përmet:

1. Të shprehet në mënyrë të qartë mbi **dakordësinë/mosdakordësinë** me propozimin për bashkimin e Bashkisë Përmet me Bashkinë Këlcyrë.
2. Të kërkojë që në shqyrtimin e mëtejshëm të reformës të merren në konsideratë mendimet e shprehura gjatë konsultimit publik dhe dokumentacioni përkatës i administruar nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak.
3. Të përcjellë vendimin e Këshillit Bashkiak, së bashku me relacionin, procesverbalet e dëgjesave dhe konsultimeve publike, mendimet alternative dhe dokumentacionin tjetër shoqërues, pranë institucioneve kompetente, në përputhje me kërkesat e procesit.

Dokumentacioni i Kuvendit parashikon që mendimet dhe dokumentacioni shoqërues i njësive të qeverisjes vendore të përcillen brenda **60 ditëve nga data e marrjes së shkresës.**

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Përmet shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit bashkëlidhur këtij relacioni.

PËRGATITI:

Sekretari i Këshillit Bashkiak Përmet

Aleks TANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA PËRMET

Scanned with CamScanner